

**LIGJ**  
**Nr.10 429, datë 9.6.2011**

**PËR RATIFIKIMIN E VENDIMEVE TË BORDIT TË GUVERNATORËVE TË BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (EBRD), REZOLUTA NR.126 “RRITJA E KAPITALIT THEMELTAR TË AUTORIZUAR, EMETIMI I AKSIONEVE TË PAGUARA DHE PAGESA, NËPËRMJET RIALOKIMIT TË TË ARDHURAVE NETO” (SHTOJCA A) DHE REZOLUTA NR.128 “SHTIMI I KAPITALIT THEMELTAR TË AUTORIZUAR, EMETIMI DHE NËNSHKRIMI I KAPITALIT TË SHLYESHËM, NËSE KËRKOHET DHE SHLYERJA” (SHTOJCA B), SI DHE DOKUMENTI “INFORMACION PËR HAPAT QË DUHET TË MERREN PAS MBLEDHJES VJETORE TË VITIT 2010”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohen vendimet e Bordit të Guvernatorëve të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), rezoluta nr.126 “Rritja e kapitalit themeltar të autorizuar, emetimi i aksioneve të paguara dhe pagesa, nëpërmjet rialokimit të të ardhurave neto” (shtojca A) dhe rezoluta nr.128 “Shtimi i kapitalit themeltar të autorizuar, emetimi dhe nënshkrimi i kapitalit të shlyeshëm, nëse kërkohet dhe shlyerja” (shtojca B), si dhe dokumenti “Informacion për hapat që duhet të merren pas mbledhjes vjetore të vitit 2010”.

**Neni 2**

Rezolutat e mëvonshme, që nuk kanë të bëjnë me marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7031, datë 29.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bamir Topi**